Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

Loti i parë: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Sistemimi i Prroit të Kallmit”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

- Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit, (Shtojca7)

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019) të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet.

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: **1,275,572** (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

3.1Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

2.3 Për kapacitetin teknik:

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **510,229** (pesëqind e dhjetë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, formularin e vlerësimit/vërtetimit për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar, ndarja në përqindje në rast bashkimi operatorësh dhe faturat tatimore përkatëse.
- b. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse dhe faturat tatimore përkatëse.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

- N.P –1 (Punime gjurmimi në tokë)
- N.P –9 (Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime)
- N.P –12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit)
- N.S – 9 (Punime strukture speciale)
- N.S – 18 (Punime topogjeodezike)

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

4. Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

5. Operatori ekonomik në listën e personelit të tij duhet të ketë 1 inxhinier ndërtimi, 1 inxhinier topograf/markshajder/gjeodet/gjeomatik, 1 inxhinier hidroteknik, 1 inxhinier mjedisi. Për inxhinierët e mësipërm Operatori ekonomik duhet të paraqesë këto dokumenta: licence profesionale individuale ose të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë, kontratë pune të vlefshme, diplomë, cv, libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit.

6. Një punësim mesatar i të paktën **10 (dhjetë)** personave, për periudhën **Dhjetor 2019 – Maj 2020** të vërtetuar me;

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhën **Dhjetor 2019 – Maj 2020**

b) Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per periudhën **Dhjetor 2019 – Maj 2020** shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.

7. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 9001-2015 (e vlefshme)**. lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

8. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme). lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007/ ISO 45001-2018 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme.

10. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë ISO 39001 -2012 (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Loti i Dytë “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i rrugës ”Jusuf Gërvalla”.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

- Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit, (Shtojca7)

b. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019) të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet.

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019)

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: **1,076,210** (një milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

3.1 Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **430,484** (katërqind e tridhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, formularin e vlerësimit/vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar, ndarja në përqindje në rast bashkimi operatorësh dhe faturat tatimore përkatëse.

b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse dhe faturat tatimore përkatëse.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”**, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

- N.P –1 (Punime gërmimi në tokë)
- N.P –4 (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)
- N.P –7 (Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje)
- N.P –11 (Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm
dhe shpërndarjen e energjisë elektrike)
- N.P –12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit)
- N.S – 1 (Punime për prishjen e ndertimeve)
- N.S – 4 (Punime rifiniture të murures dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese)
- N.S – 6 (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese)
- N.S – 13 (Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni)
- N.S – 18 (Punime topogjeodezike)

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për liçencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për liçencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

4. Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.
5. Operatori ekonomik në listën e personelit të tij duhet të ketë 1 inxhinier ndërtimi, 1 inxhinier elektrik, 1 inxhinier topograf/markshajder/gjeodet/gjeomatik, 1 inxhinier hidroteknik, 1 inxhinier mjedisi. Për inxhinierët e mësipërm Operatori ekonomik duhet të paraqesë këto dokumenta: liçence profesionale individuale ose të jenë të përfshirë në liçensën e shoqërisë, kontratë pune të vlefshme, diplomë, cv, libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit.
6. Një punësim mesatar i të paktën **10 (dhjetë)** personave, për periudhën **Dhjetor 2019 – Maj 2020** të vërtetuar me;
 - a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Dhjetor 2019 – Maj 2020**.
 - b) Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per periudhen **Dhjetor 2019 – Maj 2020** shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.
7. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 9001-2015 (e vlefshme)**, lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
8. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 14001-2015 (e vlefshme)**, lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
9. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë **OHSAS 18001-2007/ ISO 45001-2018 (e vlefshme)** lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme.

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

10. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë **ISO 39001 -2012 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO).

Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

Shtojca 10

(Shtojcë për t’u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

- Loti i Parë: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “**Sistemimi i Prroit të Kallmit**”, me fond limit **1,275,572** (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.
- Loti i Dytë: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “**Ndërtim i rrugës ”Jusuf Gërvalla**”, me fond limit **1,076,210** (një milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

Afatet e ekzekutimit:

Për Lotin e I-rë: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Sistemimi i Prroit të Kallmit”, afati: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve (afati 3 muaj).

Për Lotin e II-të: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i rrugës ”Jusuf Gërvalla”, afati: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve (afati 9 muaj).

Shtojca 11

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”**

Detyrat:

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Për Lotin e I-rë: Prroi i Kallmit.
Për Lotin e II-të: Rruga ”Jusuf Gërvalla”

Shtojca 12

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

KUSHTET E PËRGJITHSHME Shërbimet –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t’i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha

“Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2020”

përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.

- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
